

V E N D I M
Nr.43, datë 26.1.2001

**PËR KALIMIN NË PRONËSI PA SHPËRBLIM, TË 51 PËR QIND TË AKSIONEVE TË
SHOQËRISË “SHTYPSHKRONJA TIRANA”, SH.A., NË TIRANË, PËR KRYEGJYSHATËN
BOTËRORE TË BEKTASHINJVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” ndryshuar me ligjin nr.8159, datë 7.11.1996, “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1632, datë 1.1.1996, “Për disa ndryshime në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991””, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kalimin në pronësi pa shpërblim të 51 për qind të aksioneve të shoqërisë “Shtypshkronja Tirana”, Sh.a., në Tiranë, për Kryegjyshatën Botërore të Bektashinjve.
2. Në vendimin nr.78, datë 21.1.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për ruajtjen e pronësisë shtetërore në disa shoqëri tregtare dhe ndërmarrje”, nga lista e ndërmarrjeve shtetërore, shoqërive anonime dhe shoqërive të përbashkëta në të cilat ruhet pjesëmarrja e kapitalit shtetëror, shfuqizohet pika 9.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta